



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 50 (827905)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 20 dhjetor 2024

Betimi ushtarak, premtimi solemn i misionarit të FA-së



Shqipëria nënshkruan në Bruksel marrëveshjen e Partneritetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes me BE-në

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu mori pjesë në Samitin dyditor të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s, në Bruksel. Ky Ministerial drejtohet për herë të parë nga sekretari i ri i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte. Në qendër të diskutimeve të Ministrave të Mbrojtjes ishte strategjia për të vepruar më shpejt dhe më efektivisht, me theks të veçantë në investimet në kapacitete dhe teknologji të reja. Vendet e NATO-s theksuan në këtë samit mbështetjen e pakursyer ndaj Ukrainës në betejën e saj për paqe.

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu së bashku me ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Igli Hasani nënshkruan në Bruksel, me përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian znj. Kaja Kallas, Marrëveshjen e Partneritetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Firmosja e kësaj marrëveshjeje zyrtarizon bashkëpunimin e zgjeruar në fusha të ndryshme të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu e cilësoi marrëveshjen impuls cilësor i ndërveprimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në kuadër të rrugëtimit të pakthyeshëm të integritimit në BE.

“Tashmë do të kemi më shumë mundësi dhe instrumente europiane për fuqizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, ndërkohë që jam i bindur se do të japim më të mirën dhe do të shtojmë vlerë në angazhimet operationale të Bashkimit Evropian”.



Nënshkrimi i dokumentit nga ministrat Hasani dhe Vengu vjen në kuadër të samitit BE-Ballkani Perëndimor, ku Shqipëria përfaqësohet nga një delegacion i nivelit të lartë i drejtuar nga Kryeministri Edi Rama.

Mesazhi i fortë politik për rëndësinë, tani më shumë se kurrë, i partneritetit strategjik midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, një partneritet që po përparon në terma dhe veprime konkrete është objektivi kryesor i Samitit BE-Ballkani Perëndimor.

Ky është samiti i parë i thirrur nga presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, ku u mbajt konferenca e tretë ndërqeveritare Shqipëri-BE, ku vendi hapi dhe grup-kapitullin 6 të negociatave.

Ministri Vengu prezantoi në Komisionin Parlamentar të Sigurisë projektligjin për Forcën Rezerviste

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu prezantoi në Komisionin Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë fjalës së tij para deputetëve të komisionit, ministri Vengu tha se: “Qëllimi i kësaj nisme ligjore është kompletimi i strukturës së shërbimit ushtarak në rezervë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke garantuar nivelin e gatishmërisë, duke synuar rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes për të përmbushur me sukses operationet, në të cilat kjo forcë përfshihet si dhe të rregullojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për rekrutimin dhe shërbimin në forcën rezerviste”.

Sipas ministrit të Mbrojtjes: “Kjo ndërhyrje mbështet objektivat e nivelit të lartë të qeverisë, pasi do të mundësojë ngritjen e një trupe rezerviste bashkëkohore, në përgjigje të kërkesave të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, duke rritur kështu numrin e këtij komponenti deri në 20% të forcës aktive”.

Ministri tha se, sipas Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FA-së, është parashikuar që numri i personelit rezervist të FARSH do të jetë rreth 2100 vetë, në rast se kushtet dhe mjedisi i sigurisë nuk kërkojnë rritjen e tij: “Ndryshimi i mjedisit të sigurisë kohët e fundit, por edhe sfidat e viteve dhe dekadës së ardhshme kërkojnë që vendi ynë të rritë në maksimum kapacitetet dhe sinergjitë e forcave aktive, ndërkohë që është i nevojshëm zhvillimi i një force rezerviste të integruar në forcën aktive, me role dhe detyra të reja dhe të përcaktuara qartë”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu.

Kohëzgjatja e shërbimit si rezervist është nga 14 deri në 45 ditë në vit, por ky afat mund të jetë më i gjatë në rast se kërkohet stërvitje



më specifike, pjesëmarrje në operatione apo misione ushtarake ndërkombëtare të drejtuara nga OKB/NATO/BE, në operatione apo misione humanitare ndërkombëtare të drejtuara nga BE, apo në operatione në mbështetje të autoriteteve civile në emergjencat civile.

Sipas projektligjit të paraqitur kanë të drejtë t'i bashkohen forcës rezerviste shtetasit shqiptarë që nuk janë të dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerje të një

krimi dhe nuk kanë mbushur moshën: 50 vjeç për ushtar; 55 vjeç për nënoficer; 60 vjeç për oficer.

Shtetasit që do t'i bashkohen shërbimit rezervist do të nënshkruajnë kontratën për shërbimin ushtarak në rezervë, për një periudhë jo më pak se 2 vjet me të drejtë rinovimi. Gjatë kohëzgjatjes së shërbimit si rezervist, në projektligj parashikohet që subjektet shtetërore dhe private në rast kur njoftohen apo kur u kërkohet aktivizimi janë të detyruar të japin leje

në periudhën e kërkuar, pa krijuar pengesa apo vonesa, pasi dihet që ky shërbim ka një rëndësi të veçantë për publikun. Qeveria parashikon të shpenzojë 1.694.704.920 lekë si kosto fillestare e aktivizimit e përllogaritur për një numër efektivësh prej 2100 vetë, që përshtin armatimin, mjetet dhe pajisjet taktike, set-in individual dhe uniformën. Ndërsa totali i koston të implementimit të komponenti rezervist do të jetë 2.621.577.432 lekë.



Betimi ushtarak, premtimi solemn i misionarit të FA-së

Para flamurit kuq e zi u betuan në një ceremoni të veçantë 116 oficerë të rinj, 38 kadetë dhe 78 studentë, mes të cilëve 10 janë nga Kosova. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj si dhe gjeneralë, komandantë forcash e familjarë të studentëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri Vengu theksoi rëndësinë e këtij momenti për jetën studentore ushtarake dhe ndikimin që ai do të ketë gjatë gjithë karrierës së këtyre të rinjve në radhët e Forcave të Armatosura: “Betimi Ushtarak është një vazhdim i traditës së besëlidhjes, i dhënies së fjalës në kuvende popullore ose para luftëtarëve të organizuar për liri e pavarësi në shekuj. Asgjë më shumë nuk do t’ju japë nder, siguri dhe dinjitet, sesa uniforma e ushtarakut, uniformë e cila sot qëndron denjësisht përkrah aleatëve në NATO. Në 4 vitet e ardhshme ju do të mësoni peshën dhe përgjegjësinë, por edhe fisnikërinë e uniformës. Akademia e Forcave të Armatosura në formimin e gjeneratës së re të oficerëve duhet të ketë si pikësynim për të diplomuar individë që janë të certifikuar në angazhimin, përkushtimin ndaj vendit, karakterin e kompetencën”, - u shpreh ministri Vengu.

Ministri i Mbrojtjes tha se sot, po kryhen një sërë hapash realë në zhvillimin e Forcave të Armatosura të RSH-së, për sa i përket trajtimit të ushtarakut, transformimit dhe modernizimit të FARSH.

Në mbyllje të fjalës së tij, ministri Vengu shprehu falënderimet për stafin akademik dhe personelin komandues për arritjet dhe përmbushjen e objektivave të programit të trajnimit.

Më tej fjalën e rastit e mbajti komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, i cili iu drejtua studentëve dhe kadetëve: “Kam nderin e privilegjin t’ju uroj mirëseardhjen në ceremoninë e betimit ushtarak, e cila është një nga ngjarjet më të shënuara në karrierën e çdo ushtaraku. Ajo lë gjurmë të pashlyeshme në memorien e gjithsecilit nga ju. Sot, ju studentë e kadetë me betimin ushtarak bëni një hap të rëndësishëm në jetën e karrierën tuaj. Ky është një angazhim e përgjegjësi e madhe që kërkon gjithçka nga ju: guximin, forcën, përkushtimin dhe inteligjencën për të përballuar çdo sfidë e detyrë në shërbim të Atdheut.

Betimi nuk është thjesht një detyrim ushtarak, por një angazhim ndaj vlerave më



të larta të shoqërisë, ndaj mbrojtjes së sigurisë dhe sovranitetit të vendit tonë. Pas një periudhe pesë dhe dhjetë javore, trajnimi e stërvitjeje intensive në Qendrën stërvitore Bunavi, Vlorë,

ju rreshtoheni këtu sot, më të përgatitur, më të motivuar e tashmë të gatshëm për të shërbyer me përkushtim dhe vetëmohim. Detyra ushtarake kërkon përgatitje të vazhdueshme për

t’u përmirësuar dhe për të ruajtur nivelin më të lartë të aftësive dhe njohurive, pasi Ju do të mbani mbi shpatulla një përgjegjësi të madhe: mbrojtjen e sigurinë e qytetarëve tanë, si dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve në shërbim të paqes në kuadër të aleancës së Atlantikut”.

Më tej gjeneral brigade Nuredinaj u shpreh: “Detyra fisnike e ushtarakut është e vështirë, por e nderuar dhe e lavdishme. Ajo që ju do të përjetoni gjatë karrierës tuaj, mund të jetë përballje me sfida të mëdha, por gjithashtu do të jetë një mundësi e çmuar për rritjen tuaj profesionale dhe personale. Akademia e Forcave të Armatosura, ku ju do të studioni e përgatiteni, përfaqëson një institucion modern të arsimit të lartë në nivel kombëtar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe është një “laborator” i formimit të gjeneratës së re të oficerit, liderit të ardhshëm në Forcat e Armatosura.

Falënderoj Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm për kujdesin dhe mbështetjen e plotë që po i japin Akademisë e Forcave të Armatosura dhe në veçanti studentëve dhe kadetëve”, - mbylli fjalën e tij gjeneral brigade Nuredinaj.

Në këtë ceremoni u betuan 38 kadetë, të cilët do të vijnë për një vit studimet pasuniversitare për oficerë dhe 78 studentë të rinj, të cilët do të studiojnë për 4 vjet pranë Akademisë së Forcave të Armatosura.





Gjenerallejtënant Arben Kingji priti atashetë e huaj ushtarakë në vendin tonë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në një takim të veçantë atashetë e huaj ushtarakë rezidentë dhe jo rezidentë në vendin tonë.

Gjenerallejtënant Arben Kingji mes të tjerash falënderoi atashetë e huaj ushtarakë për kontributin dhe angazhimin e vyer të gjithsecilit prej tyre në drejtim të rritjes së bashkëpunimit ushtarak në nivel dypalësh, rajonal dhe në kuadër të Aleancës.

Me anë të një prezantimi, atashetë e huaj ushtarakë u njohën me zhvillimet më të fundit në Forcat e Armatosura të RSH-së, si dhe synimet dhe objektivat për të ardhmen.



Gradohet personeli oficer i Forcës Ajrore

Në mjediset e Komandës së Forcës Ajrore, Rinas, u zhvillua ceremonia e dhënies së gradave për personelin oficer të Forcës Ajrore.

Kjo ceremoni u hap me leximin e urdhrit të ministrit të Mbrojtjes për dhënien e gradave personelit oficer dhe vijoi me dorëzimin e gradave të radhës për të gjithë të graduarit. Me këtë rast, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, duke i uruar atyre suksese për gradimin e merituar ndër të tjera theksoi: "Procesi i gradimit tuaj ka lidhje me atë çka ju keni investuar përgjatë karrierës suaj për vetveten tuaj, por dhe me ndikim në ndryshimin që i keni dhënë performancës së Faj-së. Përparimi në gradë nuk ju bën vetëm ju krenarë, por na bën edhe ne, Forcën Ajrore dhe në tërësi Forcën e Armatosur. Karriera juaj tashmë është e sigurt, ajo çka do dëshiroja nga ju është që të vazhdoni të rrisni performancën tuaj, ta lartësoni gradën që morët, t'i jepni vlerën si qytetarë dhe ushtarakë dinjitozë të vendit dhe FARSH". Aktiviteti u mbyll me një foto të përbashkët.



Vizitë e Ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjatë zhvillimit të masterave në Akademinë e Forcave të Armatosura

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji dhe komandanti i Akademisë gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, vizitoi Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, aty ku zhvillohen programet e studimit të ciklit të dytë. Ministri Vengu pa nga afër infrastrukturën moderne dhe të avancuar për zhvillimin e mësimin teorik dhe praktik si dhe bisedoi me pedagogët dhe studentët e tre programeve master që AFA ofron. Ai përgëzoi studentët që zgjedhën dhe besuan te Akademia e Forcave të Armatosura dhe ofroi mbështetje për ta dhe stafin pedagogjik.

Më pas, zoti Vengu zhvilloi një bashkëbisedim me studentët e programit Master i Shkencave në “Siguri dhe Politikë Ndërkombëtare në fushën e Mbrojtjes”, ku biseda u fokusua te interesi kombëtar dhe siguria kombëtare.

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi nevojën për një vëmendje më të madhe të shoqërisë sonë në përgjithësi ndaj kërcënimeve të sigurisë edhe në vende në dukje të largëta, siç janë aktualisht Ukraina apo Lindja e Mesme, efekti i të cilave mund të arrijë deri në Shqipëri. Gjithashtu, zoti Vengu përmendi shembuj konkretë të kërcënimeve të aktorëve të huaj mbi infrastrukturën kritike si në Shqipëri, por edhe së fundmi në Kosovë, e cila pas sulmit terrorist në kanal in e Iber - Lepencit, më 29 nëntor, u mbështet nga ana energjetike për plot 48 orë nga Shqipëria falë interkonjeksionit mes dy vendeve.



Më tej, ministri përmendi edhe Industrinë Ushtarake të vendit tonë, shkatërrimin e së cilës e konsideroi si një gabim shumë të madh. Ai e cilësoi industrinë ushtarake jo si një industri vetëm të Forcave të Armatosura, por si një industri mbështetëse për gjithë ekonominë e vendit, për të cilën tha se me ndryshimet e fundit ligjore, janë ndërmarrë hapat e nevojshëm për ta ringritur atë industri.

Në përfundim, të pranishmit shprehën dëshirën dhe fuan ministrin e Mbrojtjes për të mbajtur një orë leksion për tema që lidhen me Sigurinë dhe Mbrojtjen.

Për vitin akademik 2024 - 2025, Akademia e Forcave të Armatosura ofron tre programe të avancuara të ciklit të dytë të studimeve që mbulojnë disa nga fushat më të rëndësishme të mbrojtjes, sigurisë kibernetike dhe inteligjencës artificiale, duke kontribuar në zhvillimin e profesionistëve të kualifikuar për t'u përballur me sfidat e sigurisë globale. Këto programe ofrojnë mundësi të shkëlqyera për studentët që kërkojnë të avancojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në këto fusha kritike.

Studentët e programeve të studimit të ciklit të dytë për vitin akademik 2024 - 2025, vijnë si ushtarakë aktivë nga Forcat e Armatosura, punonjës të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, institucioneve të tjera të sigurisë në vend dhe nga jeta civile.

Akademia e FA-së po përgatitet që shumë shpejt të ofrojë edhe programet e studimit të ciklit të tretë, ato të doktoraturës.

Aktivitetet sportive janë elementë të domosdoshëm, në ruajtjen e aftësive dhe performancës fizike, të cilat i shërbejnë kryerjes së detyrave dhe gatishmërisë luftarake të burimeve tona njerëzore. Përgatitja fizike zë një vend të veçantë dhe shumë të rëndësishëm tek të rinjtë dhe të rejtat që sot janë pjesë e Forcave të Armatosura.





KOLONEL (R) SALI ONUZI

Në Akademinë e Shkencave, me rastin e 95-vjetorit të lindjes së ish-presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, u organizua një sesion jubilar në të cilin kumtuan akademikë, studiues së historisë ushtarake, përfaqësues të shoqatave të ndryshme, të cilët sollën në vëmendje jetën dhe veprimtarinë patriotike - ushtarake të ish-presidentit Moisiu. Mes kumtuesve të shumtë kolonel (R) Sali Onuzi solli një panoramë të gjerë të rrënjëve të familjes Moisiu, ku mes të tjerash u shpreh se: “Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare ka qenë një epokë sa heroike aq edhe e vështirë për t’u përballuar. Në veçanti familja Moisiu, e komandantit të Shtabit Madhor të LANÇ, gjeneral Spiro Moisiut ishte e ndjekur këmba këmbës. Familja dhe Moisiu, Alfredi, për t’iu shpëtuar agjentëve dhe policisë e xhandarmërisë kanë ndërruar për 2 vjet e gjysmë më shumë se 21 vendbanime..., ndërrimi i vendbanimeve nuk mund të ishte thjesht një çështje fizike, kuptohet se sa shqetësime shpirtërore krijonin ato.

Territori ku lëvizte familja Mosiu ishte Lushnjë, Kavajë, Shijak, Pezë dhe Tiranë. Ky territor ku ishte përqendruar edhe forca më e madhe ushtarake e pushtuesve italianë e gjermanë përbënte një rrezik më të shtuar se kudo. Por këtu ishin edhe miqtë (si Vasip Alushi etj.) dhe shokët e Spiro Moisiut.

Lëvizja ANÇ ishte fort mirë e organizuar. Zgjedhja e Spiro Moisiut në postin e lartë të komandantit të UNÇ-së i shtonte kërkimet e agjentëve për të zbuluar e gjetur familjen e tij, për ta pasur si peng, ose për ta masakruar. Po kaq në mos më shumë ishte sjellja klandestine në mjedisin e ri ku shkohej. Gjithmonë duhej shpikur një legjendë e re për familjen Mosiu, sikur ishin miqtë e të zotit të shtëpisë, sikur kishin ardhur aty e nuk dilnin aq jashtë, meqë ishin në gjak e plot të tjera.

Në çdo rast Lëvizja i pajiste me letërnjoftim të rremë, Afredi - Tomorr, Kuka. Nuk ishte aq e thjeshtë që menjëherë të transformohesh nga (Alfred në Tomorr). Këto emra, thotë Moisiu, na u bënë aq të njohur sa na u desh kohë të ktheheshim në identitet pas daljes në zonat e lira.

Alfred Moisiu i mban mend dhe i tregon me saktësi rastet që i kanë dalë para gati për ta demaskuar padashur, shoku i tij shkollës që i drejtohej në mes të tjerëve në lagje. “O Alfred!”, dhe ky, “nuk jam Alfredi”, po një shok i tij, a një afërm i tij, se: “Alfredi ka dalë bashkë me babanë” dhe tjetri: “e mori në qafë ai” etj. Ndodhte gjithnjë që pas njohjeve të tilla, të njoftoheshin shokët e Lëvizjes, dhe menjëherë, brenda ditës e natës, familja bëhej gati dhe nisej për udhë, madje ëma e Alfredit, ortodokse, e veshur si myslimane. Dhe kish ndodhur shpesh që menjëherë pas largimit të familjes t’ia behnin aty forcat e xhandarmërisë e të policisë, madje edhe forca balliste, duke pyetur në lagje, ose deri në shtëpi se ku është familja e major Spiros. Banorët bënëin të habiturin “po ne këtu jemi gjithë mysliman, nuk ka këtu ortodoks!”. Familja Moisiu është një nga rastet e shumta të gërshetimit organik të përkryer të Luftës dhe të Lëvizjes ANÇ. Ato kanë qenë një binom i pandashëm.

Alfred Moisiu u përfshi që herët në moshën 10 vjeçare në Lëvizjen antifashiste, edhe pa dëshirën e tij, që ditën e 7 prillit 1939, kur i ati drejtonte forcat e batalionit “Taraboshi”, që komandonte kundër agresorëve fashiste italianë. Por në mënyrë aktive Alfred Moisiu do të përfshihej në Lëvizjen Nacionalçlirimtare sapo të vinte në gjimnaz në Tiranë...

Më tej koloneli në kumtesën e tij do të sillte elementë të veçantë të sakrificës dhe luftës së paepur të familjes Moisiu: Gjimnazi ishte një çerdhe antifashiste e një lëvizjeje ilegale e klandestine, në fillim në forma të thjeshta, me lexime komunikatash, apo me një shfaqje teatrale, me biseda e lexime artikujsh të “Kushtrimit të Lirisë” etj. Moisiu i ri, veç tjerash pati rast ta provonte dhe spiunimin në kuesturën fashiste për shkak të disa parullave të hedhura në autobusin e linjës Lushnjë-Tiranë. Po shumë shpejt do të ngrihej edhe në gjimnaz bashkë me rininë e Tiranës shkalla e dallga e Lëvizjes, me protesta e demonstrata të fuqishme kundër pushtuesve mu në zemrën e kryeqytetit, te Bashkia. Ishin një grup vajzash

Alfred Moisiu dhe familja e tij në lëvizjen dhe LANÇ



që dilnin në fillim me flamur aty në mes të rrugës ku ishte dikur “Zëri i Popullit” dhe, sapo ato hapnin flamurin e fillonin këngën “eja mblidhuni këtu-këtu”, suleshin nga të katër anët grupet e tjera

që bashkoheshin e lidheshin dorë për dorë për të bërë një front të pathyeshëm kundër policisë e xhandarmërisë.

Më 1942 dolën në një demonstratë për të kundërshtuar



“LUFTA ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE KA QENË NJË EPOKË SA HEROIKE AQ EDHE E VËSHTIRË PËR T’U PËRBALLUAR. NË VEÇANTI FAMILJA MOISIU, E KOMANDANTIT TË SHTABIT MADHOR TË LANÇ, GJENERAL SPIRO MOISIUT ISHTE E NDJEKUR KËMBA KËMBËS. FAMILJA DHE MOISIU, ALFREDI, PËR T’IU SHPËTUAR AGJENTËVE DHE POLICISË E XHANDARMËRISË KANË NDËRRUAR PËR 2 VJET E GJYSMË MË SHUMË SE 21 VENDBANIME...,



SPIRO MOISIU ËSHTË
USHTARAKU E BURRI QË
KA MARRË PJESE NË TË
GJITHA FORMAT E ZHVILLIMIT
TË LUFTËS ANÇ. ASNJË
DREJTUES TJETËR I LANÇ-IT
NUK KA KËTË PJESEMARRJE
KAQ TË GJERË E TË LARTË
NJËKOHËSISHT, NË LËVIZJE
DHE NË LUFTË SI GJENERAL
SPIRO MOISIU.

ekzekutimin me vdekje të 12 të të dënuarve antifashistë. Studentët kërcyen murin rrethues të Shkollës e dolën në rrugë. Pas përleshjes me policinë demonstrata u shpërnda. Moisiu i vogël u fut në një dyqan nën banak, i zoti i të cilit nuk e tregoi kur erdhën policët, po i tha këtij “po ç’është duhet ty more xhaj, kaq i vogël të përzihesh në këto punë?”. Në këto demonstrata njëra pas tjetrës, përleshja me policinë ishte fundi i zakonshëm i tyre.

Jeta ilegale i kufizoi lëvizjet e daljet e lira, po i shtoi Moisiut nxënës (student siç rriteshin aso kohe) pasionin e leximit të letërsisë artistike dhe të mësimin të gjuhëve të huaja. Pasioni i tij për matematikën ishte zhvilluar gjithashtu po herët.

Jeta ilegale e Alfred Moisiut dhe familjes së tij u ndërthur me dy kalime në zonat e lira, njëherë në Pezë, pas kapitullimit të Italisë fashiste dhe së fundi në Skrapar në pranverë 1944, e prej aty në Berat e Tiranë. Kalimi në zonat e lira bëhej në sekret të plotë. Jeta në këto zona ishte edhe një njohje e re, një kureshtje për jetën partizane. Sheh dhe fikson në kujtesë takimet e tij me udhëheqësit partizanë, edhe avionët anglezë të furnizimit dhe furnizimet e tyre, edhe oficerin anglez aty që koordinonte veprimet me Shtabin tonë të Përgjithshëm, shikon se si në Pezë vinin çdo dy-tre ditë grupe të rinjsh punëtorë e studentë nga Tirana për në repartet partizane. Aty, në Pezë, pa për herë të parë edhe një rob gjerman, që dukej i frikësuar.

Që në Pezë Moisiu i vogël aspironte të bëhej partizan, prandaj i hyn stërvitjes, bën qitje me automatik anglez në poligon, stërvitet disi, por deri këtu. Kërkesën e tij për të qëndruar me të edhe më tej, Spiro nuk ia pranon. Lufta po egërsohej dhe Alfredi i dukej ende i

vogël, pa i mbushur ende 14 vjet.

Hera e dytë dhe e fundit në zonat e lira para Kongresit të Përmetit, kur shkuan nga Kavaja në Skrapar e u vendosën në Staraveckë. Gjatë rrugës u ndalën në Pezë... Këtu u pajisën me rroba angleze dhe secili me një gavatë. Alfred Moisiu kërkoi të armatohej e të futej, së paku, në shërbimin e rojës, sepse nëpër aksione nuk e lejoni. U gëzua tepër kur një natë, bashkë me partizanë të tjerë e caktuan në aksionin e pritjes së materialeve angleze që do të hidheshin me parashutë.

Ruga nga Peza në Skrapar ishte një marshim i vërtetë në kushte të vështira. Në Staraveckë, ku u vendosën, u njoh shpejt me jetën partizane të Shtabit të Përgjithshëm. Në Helmës u njoh dhe me zyrën e Kryetarit të Shtabit Madhor, një zyrë e thjeshtë pune, së cilës nuk i mungonin hartat dhe elementët e domosdoshëm për punë. Këtu Alfred Moisiu ia arrin të përfshihet në përbërje të kompanisë së sigurimit të Shtabit, të Kryesisë e Komitetit antifashist. Pra e filloi jetën ushtarake si gardist, jo vetëm çdo mëngjes për nder armë në ngritjen e Flamurit Kombëtar, por edhe në shërbim të përditshëm e të përnatshëm në rojë.

Me këtë kompani të sigurimit Moisiu do të ishte në udhëtimin e udhëheqjes për në Berat, të qëndrimit të tyre aty disa javor dhe pastaj të rrugës për Tiranë me 28 nëntor 1944, ku kompania e tij ishte vendosur në dy anë të rrugës për të siguruar udhëheqjen e re.

Pjesëmarrja në Lëvizje dhe në Luftë e Moisiut dhe familjes së tij kishte lidhje drejtpërdrejt me ato të Spiro Moisiut, emri i të cilit u bë popullor që në ditën e parë të agresionit fashist Italian me qëndresën e batalionit “Tomori” në Shëngjin, e pastaj edhe më

shumë me tërheqjen nga fronti i luftimeve italo-greke. Më 1942, Spiro Moisiu ishte zgjedhur kryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar të qytetit të Lushnjës, ku i kushtoi një kujdes të veçantë njësiteve guerile dhe formimit të çetave partizane. Më 1943 ai u thirr në Labinot ku u zgjodh anëtar i Shtabit Madhor të Luftës ANÇ dhe një ditë më pas dhe kryetar i tij. Zgjedhjen e tij në këtë post të lartë Alfredi dhe familja e mësuan nga një komunikatë që ua solli dikush. Spiro Moisiu ishte një patriot i vërtetë, siç thoshte e ëma, Ançe ai, kur është punë për hallet e Shqipërisë, i harron fare familjen dhe shtëpinë (i ankohej Alfredit gjyshja e tij). Kur Spiro Moisiu dhe komanda e SHP-së ishin rrethuar në Çermenikë në dimrin 1943-44, familja nuk dinte gjë për jetën e tij, madje dëgjoheshin zëra se ishte vrarë ose se kishte përfunduar te pushtuesit. Merre me mend se ç’emocione zgjonte lajmi për gjendjen e tij shëndosh e mirë!

Spiro Moisiu është ushtaraku e burri që ka marrë pjesë në të gjitha format e zhvillimit të Luftës ANÇ. Asnjë drejtues tjetër i LANÇ-it nuk ka këtë pjesëmarrje kaq të gjerë e të lartë njëkohësisht, në Lëvizje dhe në Luftë si Gjeneral Spiro Moisiu.

Veprën e Spiro Moisiut, shteti shqiptar e ka çmuar me dekoratën më të lartë atë të Flamurit kombëtar. Ai ishte një antifashist i madh shqiptar, një nga gjeneralët fitimtarë të Luftës së Dytë Botërore.

Së fundi dua të shtoj se qenia e z. Alfred Moisiu në Lëvizjen e në Luftën ANÇ personalisht, e babait të tij në krye të ushtrisë partizane, ka qenë një nder i madh për të gjithë detyrat që Ai ka kryer në karrierën e tij. Këto simpoziume janë vlerë kombëtare, sepse mbajnë gjallë kujtesën historike për të cilën ne shqiptarët do të krenohemi ndër breza.



Gruaja shqiptare në tre kohë



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Eshkuara, e tashmja dhe e ardhmja e gruas shqiptare, nga një grua për optikën e një burri, i cili vjen në jetë nga një grua, burrërohet nga një grua, maturohet prej një gruaje dhe shtazërinë mashkullore e tregon mbi këtë qenie që botës i jep jetë.

Gruaja është jeta, dhembja, dashuria. Ajo ka dhënë dhe vazhdon ta bëjë me dinjitet kontributin e saj si heroinë e betejave jetësore si shqiponjë mbi trojet tona stërgjyshore në të shkuarën dhe të tashmen....

Gruaja shqiptare është shtylla e shoqërisë

Femra shqiptare si nënë, si qytetare, si rrezatuese e familjes shqiptare ka dhënë një kontribut në të kaluarën si heroinë e betejave jetësore. Si nënë, ajo mbetet heroinë e kohës, mbi supet dhe shpirtin stoik të saj vërshuan shumë beteja dhe gjithmonë doli faqebardhë. Ishte dhe mbeti përherë krah i fortë i burrit dhe shtyllë e fortë e familjes dhe atdheut. Dje ishte krah për krah pranë burrit, pranë pushkës dhe pranë diturisë. Sot ajo është më shumë pranë vatrës së diturisë. Dje e nëpërkëmbur nga shoqëria?! Sot atë e gjejmë në çdo fushë jetës, ajo sot është kudo, në rrugën e dritës, është mosnënshtrimi. Po nesër? Nesër do të jetë edhe më e përgjegjshme për jetën, familjen, shoqërinë. Ajo sot mori frerët e jetës me këmbënguljen e saj me qëndresën e saj, me çelësin e diturisë. Sot dhe nesër është pjesë e qytetërimit njerëzor. Nesër do të jetë prapë themeli më i fortë i dashurisë, vullnetit dhe përparimit.

Të jesh femër në Shqipëri!

Kultura e të qenit femër në Shqipëri është ajo e një dhune psikologjike dhe sociale, që mjedisin e mbush me mllef, nëse i duhet dikur të rebelojë (pasi ku mungon reforma nis revolucioni), nëse nuk pranon kuadrin e përgjithshëm në të cilin kjo shoqëri kërkon ta vendosë dhunshëm. Një rebelim i tillë është divorci.

Pasoja që sjell, përveç “vdekjes së vogël” të jetës së kaluar, shpesh për t’i dhënë fund një stresi të vazhdueshëm që pjell çrregullime psikologjike e në raste ekstreme edhe psikike, sjell edhe një jetë të konsideruar si të pasuksesshme në vazhdim, pra një diskriminim të ri social ndaj femrës. “E la burri të shkretën. Kush dreqin e di ç’i ka bërë qyqarit!”.

Një tjetër tragjedi sociale nis. Një femër për t’u treguar me gisht, për t’u sulmuar prej të gjithë aventurierëve të një ndërgjegjeje të pashpirt. Një tjetër viktimë-femër që duhet të shndërrohet në burrë për të mbijetuar...

Kultura e të qenit femër në Shqipëri sot lidhet me një stereotip të ri njerëzor që duhet të kapërdijë hidhërimin e tradhtive të bashkëshortit bashkëkohor me “dinjitet”.

I duhet të mos ulërijë, pasi ky është mashkulli i suksesshëm për shqiptarin që ka nisur të mëkëmbet ekonomisht përballë një femre, që nëse do ta tradhtonte të shoqin, shoqëria e “moralit” në Shqipëri do ta dënonte tmerrësisht ashpër, nën gjykimin “e drejtë” si të përdalë, të pamoralshme, të pandershme e gjithçka vulgare. Për të njëjtin mëkat qëndrimi social sigurisht që do të ishte edhe këtu diferencial. Burri, kjo qenie kaq e adhuruar prej vetvetes në jetën shqiptare do të quhej i zoti, ndërsa gruaja e ndyrë dhe e pështirë.

Shpesh qëndrimet mohuese e ndëshkuese ndaj femrës arrijnë deri në hakmarrje. Sa krime për “motive të dobëta” realizohen në Shqipëri për tradhtinë bashkëshortore! Madje nga burra që kanë tradhtuar kush e di sa herë gruan e tyre. Pa analizuar aspak arsytet dhe pasojat, shqiptari kalon përherë në ekstrem me “krenarinë” mashkullore dhe “fëlliqësinë” femërore. Sa marrëdhënie të dyfishta e shpesh të shumëfishta?!

E ndershme për ndërgjegjen sociale është femra që nuk bën dashuri, krenar është mashkulli që ka një listë të gjatë femrash në triumfet e veta. Por, të dyja këto raste janë profile psikologjike të sëmura në jetën seksuale të njeriut, nëse mungesa e seksit është absolute për femrën dhe poligamia qëllim në vetvete për mashkullin.

Eja dhe shuaja shqiptarit absurd e agresiv tabunë sociale të seksit, pa ekuilibrimin shpirtëror

Eja dhe thuaji shqiptarit se koncepti i burrneshës apo kapedanes e shndërron femrën në mashkull e pasoja e parë dhe më e rrezikshmja është lindja dhe rritja e një mashkulli të pasigurt, frikacak e të dobët në shpirt që vishet me petkun e një agresori të dhunshëm social. Si t’i thërrmosh këto koncepte sociale të rrënjosura



tashmë në ndërgjegje të sëmurë?

Shqiptari i sotëm ndodhet përballë një femre të lirë e të pavarur, e cila ka nisur të çlirohet prej mbetjeve patriarkale të së shkuarës. Kjo barazi e huton disi mashkullin shqiptar, i cili vjen prej një piedestali të rrënuar të një mbetjeje patriarkale të lodhur.

Vetëm atëherë kur meshkujt dhe femrat me dëshirë të plotë të marrin përgjegjësitë, duke iu përkushtuar vetvetes në arritjen e një suksesi të tyre dhe duke humbur vetveten në sfidat e mundshme mbi përgjegjësitë e tyre, ne do të kemi një botë më të mirë. Është parësore puna e burrit të plotësojë së pari përgjegjësinë e tij dhe të përkrahë gruan dhe bijat e tij të jenë përgjegjëse dhe të kënaqura me detyrat e të qenit femër...

Lufta e grave për të zënë vendin që iu takon

Femrat që luftojnë kundër mentalitetit patriarkal dhe të vjetruar, apo edhe ato që nuk janë viktimë e këtij mentaliteti por thjesht duan që zëri i tyre të dëgjohet, të jenë pjesë aktive e shoqërisë, cilin model duhet të ndjekin, ose thënë më mirë: a ekziston një model i tillë në shoqërinë tonë, të mbytur nga komplekset e shumta?

Kohëve të fundit, çdo ditë e më shumë jemi dëshmitarë të bastardimit të imazhit të femrës, ku përballemi me dy ekstreme të shoqërisë shqiptare, njëra anë përpiket t’i gjejë dhe t’i avancojë këto vlera aq shumë të proklamuar dhe ana tjetër në mënyra të ndryshme i hedh poshtë dhe bën të duken të parëndësishme.

Çka është edhe më shqetësuese, është fakti se ky fenomen social përveç që manifestohet tradicionalisht nga gjinia e kundërt, të cilët janë edhe sot faktorë të rëndësishëm në këtë çështje, por gjithashtu ky shtrembërim i imazhit të femrës, në masë të madhe bëhet edhe nga ana e një pjese të caktuar të gjinisë femërore.

Në ditët e sotme ka informacione të bollshme në media, por, ajo që ndeshemi në të vërtetë secili prej nesh, është përpjekja mbi përcaktimin e asaj se çfarë është vlerë dhe anti-vlerë. Kur, jemi te imazhi i femrës shqiptare dhe ajo çka ato përçojnë në paraqitjet e tyre publike, na paraqitet e njëjta dilemë. Sapo, hapim kanalet televizive, celularët, rrjetet sociale, gazetatat e shkruara, përballemi me individë, kryesisht femra që sot kanë ndikim në një grup-moshë relativisht të re. Mesazhi që përcjellin shpesh lë për të dëshiruar.

Ajo që më step është koha e tretë e gruas, e ardhmja. Ku stereotipat më lenë të kuptoj se koha që po vjen është larg imazhit të femrës produkt i së shkuarës dhe të tashmes. Në këtë botë të

industrializuar kushdo duhet të gjejë vendin dhe formatin e saj, pa veshur ‘kostumin’ që nuk i shkon për të prishur imazhin që me aq mund gratë kanë ndërtuar.

Imazhi i femrave në karrierë inspirim apo...?!

Shpesh lind pyetja, femra që kanë arritur të zënë një vend, në jetën shoqërore dhe politike të këtij vendi të vogël, a po përcjellin vlerat e duhura të cilat do të bënin të ecte përpara këdo, në veçanti vajzat e reja që çdo ditë ndoshta edhe pa vetëdijen e tyre janë në kërkim të një roli model, për t’i avancuar aspirimet e tyre për të ardhmen?!

Jo gjithçka që kanë treguar deri tani është se, po, mund t’i futesh një pune nëse je e bukur, nëse vishesh firmato apo nëse ke dikë nga mbrapa. Gjithmonë ka përjashtime edhe në këto stereotipa, sigurisht, edhe në shoqërinë që po e ilustroj, por ironia është që llumi i anti-vlerave dalëngadalë po arrin t’i zërr frymën vlerave. Fakti që hidhet vreri mbi personalitete publike femërore, është se zëri i tyre mund të dëgjohet, nëse ato refuzojnë të mos heshtin, sepse kemi parë shumë herë se po këto personalitete publike kanë qenë pre e këtij trajtimi që i bëhet sot femrës.

Nëse duam që të kemi femra të pavarura që i kundërvihen këtij mentaliteti dhe jo t’i nënshtrohen, nëse duam të kemi barazi gjinore në raportet meshkuj-femra, cilin model duhet të ndjekë një adoleshente, por njëkohësisht cili është edhe opinioni që një adoleshent mashkull duhet të ketë mbi gjininë e kundërt?

....Të vajzës së Instagramit, asaj me rroba firmato, pjesë të një bote surreale, apo vajzës me dinjitet dhe fustanit ku ‘hired e një zonjushë’ trazojnë fantazitë mashkullore?!

Shekujt me vete kanë sjellë zhvillim dhe kuptohet dhe pasojat e tij në të gjitha dimensionet, por ato që kur nuk ka dalë nga e ashtuquajtura modë janë tre vlerat moral, dinjitet, etika. Vlerat janë njësitë matëse të veprimt njerëzor, por edhe vetë veprimi gjithashtu.

Shoqëria shqiptare mund ta shlyejë “mëkatin” e saj atëherë kur të arrijë të kuptojë se rezistenca psikologjike që bën një njeri i ndershëm për të mos u ndikuar nga e keqja e bën atë shumë herë më të fortë dhe më të vlefshëm se një njeri i cili dëshmon dobësinë që e karakterizon sa herë që pranon të flirtojë me të, dhe vetëm në këtë kohë kur kjo shoqëri ta kuptojë këtë fakt dhe femra shqiptare do jetë gati të jetojë në paqe me të ardhmen e saj, pa iu dashur të vendosë sasi filtrash dhe silikoni për të qenë mirë me të pavërtetën e tyre.



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-n

Sytë dhe vëmendja e kancelarive, institucioneve, instituteve, medias si dhe ekspertëve të sigurisë strategjike janë drejtuar në Damask, ku ky mes dhjetori festoi rrëzimin e regjimit ose dinastisë së familjes Al-Assad, që 50 vjet ka sunduar me barbari Sirinë.

Në statusin e ekspertit për çështjet e Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO-s, në vijim po paraqes një përmbledhje strategjike, mbi të kaluarën, realitetin dhe sfidat e së ardhmes së Sirisë, vendit që mban peshë kritike në Lindjen e Mesme si dhe rrafshin global.

Kush është Bashar Al-Assadi, një nga liderët më të diskutuar dhe më të kontestuar të Lindjes së Mesme, i cili është këto ditë në Top-lajmet e TV dhe mediave ndërkombëtare?

Çfarë ka qenë ai dhe dinastia e familjes së tij në gati 50 vitet e fundit?

Çfarë roli ka luajtur Siria në Lindjen e Mesme? Cilat kanë qenë marrëdhëniet e regjimit të Assadit me SHBA-të, Kinën dhe Rusinë si dhe me vendet e rajonit?

Po marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore, politike dhe fetare në vend?

Çfarë përfaqësojnë grupet rebele dhe kush janë interesat dhe ideologjitë e tyre?

Cila është e ardhmja e Sirisë në këtë udhëkryq të historisë së saj?

Kush është Bashar Al-Assad? Lindur në vitin 1965 në Damask, kryeqytetin e Sirisë, sot 59 vjeç, pas vdekjes së babait të tij, Hafez al-Assad, në vitin 2000, Bashar Al-Assadi mori drejtimin e Sirisë, duke u bërë president. Para se të futej në politikë, ai kishte një karrierë mjekësore dhe ishte i panjohur për shumicën e botës si një lider politik. Shumë shpresonin që Assadi do të sillte një frymë reformiste, por ai shpejt dëshmoi se do të ndiqte një politikë të ngjashme me atë të babait të tij, duke forcuar kontrollin e (gjithë) pushtetit si dhe duke trajtuar si fasadë ose duke shtypur opozitën. Ai ka qenë në pushtet për më shumë se dy dekada dhe ka kaluar përmes krizash të mëdha, përfshirë luftën civile që ka shkatërruar vendin me pasoja të rënda për të gjithë rajonin. Ndërkohë që shumë analistë, sidomos perëndimorë, e shohin atë si një tiran që ka shtypur popullin sirian me një regjim të dhunshëm, disa të tjerë e kanë konsideruar si një lider që ka mbajtur stabilitetin në një rajon të përfshirë nga luftërat dhe tensionet?

Pushteti i Dinastisë Al-Assad

Pushteti i Bashar al-Assad është pjesë e një dinastie që ka kontrolluar dhe drejtuar Sirinë për mbi 50 vjet. Hafez al-Assad, babai i tij, e vendosi regjimin e tij në vitin 1970 pas një grushti shteti dhe sundoi për 30 vjet. Hafez al-Assad krijoi një shtet autoritar, të centralizuar dhe përdori ushtrinë dhe shërbimet sekrete për të shtypur çdo kundërshtar. Pas vdekjes së Hafez al-Assad, Bashar al-Assad mori pushtetin dhe e ruajti këtë model autoritar, duke përdorur dhunën dhe represionin për të mbajtur pushtetin dhe kontrollin mbi vendin. Ky regjim ka mbajtur kontrollin e Sirisë për më shumë se gjysmë shekulli, duke e shndërruar familjen al-Assad në një nga dinastitë më jetëgjata të Lindjes së Mesme.

Çfarë solli regjimi i Assadit për Sirinë? Për popullin sirian, regjimi i Assadit ka qenë një burim i konflikteve dhe tensioneve të ndryshme. Nga njëra anë, ai ka sjellë një periudhë të qëndrueshmërisë, sidomos pas periudhës së trazirave dhe grushtit të shtetit të Hafez al-Assad. Siria ishte një vend relativisht i sigurt dhe me zhvillim të moderuar krahasuar me disa vende të tjera të rajonit. Megjithatë, kjo periudhë e stabilitetit ka ardhur në kurriz të lirisë politike dhe të drejtave të njeriut. Regjimi i Bashar al-Assad ka përdorur dhunën masive për të shtypur çdo formë kundërshtimi, sidomos kundër protestuesve gjatë “Pranverës Arabe” të vitin 2011 dhe shkakuar një luftë civile që ka marrë jetë të pafajshme.

Një tjetër problem është se ndërsa disa grupe, veçanërisht pakicat fetare si Alavitët (nga të cilët vjen edhe vetë Bashar al-Assad), kanë përfituar nga mbështetja e regjimit, shumica e popullsisë siriane, veçanërisht ata që ishin të lidhur me opozitën, janë shtypur dhe shtyrë në jetojnë në kushte të mjerueshme. Lufta civile ka shkakuar miliona të vdekur, të plagosur dhe të pastrehë, duke përfshirë shkatërrimin e qytetit të Aleppos dhe Damaskut.

Akuza për përdorimin e Armëve Kimike. Ka fakte dhe akuza serioze nga organizata ndërkombëtare dhe qeveri të ndryshme për përdorimin e armëve kimike nga regjimi i Bashar al-Assad kundër popullsisë civile Siriane. Ja disa prej rasteve më të njohura të përdorimit të Lëndëve Kimike nga Assadi: Sulmi në Goutha në 2013, ku besohet se forcat e Assadit përdorën Sarin, një gaz nervor i fuqishëm që shkaktoi vdekjen e mbi 1400 qytetarëve, shumica e të cilëve ishin civilë, përfshirë gra dhe fëmijë. Po ashtu, një sulm tjetër me këtë gaz nervor ishte sulmi në Khan Shaykhun, më 4 prill 2017. Ky sulm shkaktoi vdekjen e më shumë se 80 personave, përfshirë gra dhe fëmijë, dhe shumë të tjerë u plagosën rëndë. Më 7 prill 2018, u krye sulmi në Douma, gjithashtu në provincën e Idlib, ku shumë civilë raportohet se u vranë nga përdorimi i klorit, një substancë kimike e ndaluar që përdoret për të shkakuar dëm

“Fund i merituar i tiranisë Al-Assad”



të madh në frymëmarrje dhe shëndet. Regjimi i Bashar al-Assad e mohoi përdorimin e armëve kimike dhe akuzoi opozitën për ngjarjet tragjike. Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike (OPCW) ka mbledhur prova dhe ka zhvilluar hetime që kanë konfirmuar përdorimin e substancave të rrezikshme, si Sarin, VX dhe Klorin, nga forcat e regjimit sirian. Po ashtu, Këshilli i Sigurimit të OKB-së ka kërkuar ndëshkimin e përgjegjësve për këto krime, por kanë hasur vështirësi për shkak të bllokimeve nga aleatët e regjimit të Assadit, si Rusia dhe Kina.

Marrëdhëniet e Brendshme dhe Shtetet e Rajonit

Bashar al-Assad ka ruajtur marrëdhënie të forta me grupe të ndryshme të brendshme që i kanë ofruar mbështetje për mbajtjen e pushtetit, si ushtria, shërbimet sekrete dhe elita politike dhe fetare. Pjesa më e madhe e mbështetjes vjen nga grupet Alavite dhe grupe të tjera të pakicave fetare që shohin tek regjimi një garanci për mbrojtjen e interesave të tyre. Në rajon, marrëdhëniet e Bashar al-Assad janë shumë të ndërlikuara. Ai ka pasur aleatë të fortë, si Irani dhe Rusia. Irani ka mbështetur regjimin e Assadit me armë, para dhe trupa ushtarake, për të siguruar stabilitetin e regjimit në Siri dhe për të ruajtur ndikimin e tij në rajon. Po ashtu, Rusia ka luajtur një rol kyç në luftën civile, duke ofruar mbështetje ushtarake dhe diplomatike për të parandaluar rënien e regjimit të Assadit.

Nga ana tjetër, marrëdhëniet e Assadit me shtetet e tjera të rajonit kanë qenë të tensionuara. Ai ka pasur kundërshtarë të fuqishëm si Arabia Saudite, Turqia dhe disa shtete të tjera të Gjirit, të cilat mbështesin opozitën dhe janë kundër regjimit të tij. Siria ka luajtur një aktor kyç në destabilizimin e rajonit përmes mbështetjes së grupeve militante si Hezbollah dhe Hamas, duke krijuar një atmosferë të tensionuar me shtetet si Izraeli dhe SHBA.

Ndërsa marrëdhëniet e Bashar al-Assad me Izraelin kanë qenë gjithmonë të tensionuara, për shkak të konflikteve të vazhdueshme dhe politikave të mbështetjes së tij për grupet që luftojnë kundër Izraelit. Kjo ka bërë që Siria të ruajë një marrëdhënie shumë të ndërlikuar me fuqitë perëndimore dhe shtetet e tjera të rajonit që kanë njohur Izraelin.

Cilët janë Grupet Rebele dhe Axhenda e tyre?

Forcat që drejtuan rebelimin dhe rrëzuan regjimin e Bashar al-Assad janë të përbëra nga një gamë e gjerë grupesh, përfshirë grupet e opozitës civile, grupet islamike dhe grupet kurde. Këto grupe janë të shumëllojshme dhe përfshijnë një spektër të gjerë, që variojnë nga grupe islamike të moderuara, deri tek ato radikale, si dhe grupe laike. Këto grupe janë mbështetur kryesisht nga shtete si Turqia, Arabia Saudite, SHBA-të dhe disa shtete perëndimore që kanë dëshiruar të shohin rënien e regjimit të Assadit. Megjithatë, këto grupe janë të ndara dhe me axhenda të ndryshme, si dhe kanë pasur përplasje të brendshme, duke e bërë rebelimin gjithmonë e më të vështirë për t’u menaxhuar.

Në përgjithësi, rebelët mund të ndahen në disa kategori kryesore: Grupe me Orientim Islamik, të tilla, si Hayat Tahrir al-Sham (HTS), që janë më radikalë dhe kanë lidhje me ideologjinë e al-Kaidës ose grupe të tjera islamike, që synojnë një shtet islamik që i përshtatet interpretimit të tyre të Sheriatit; Grupe të Moderuara: si Ushtria e Lirë Siriane (FSA), që kanë kërkuar një qeverisje më të hapur dhe më demokratike, megjithatë këto grupe kanë qenë shpesh të fragmentuara dhe jo të konsoliduar; Grupe të Kurdëve: si YPG (Yekîneyên Parastina Gel), që ka zhvilluar një forcë të

madhe ushtarake me ndikim të madh në lindje të Sirisë. Ata janë të angazhuar për autonominë e Kurdëve në Siri, gjë që bie në kontrast me qëndrimet e Assadistëve dhe disa grupeve arabe.

Sa i përket zgjedhjeve demokratike në Siri, qëndrimet e rebelëve janë të ndryshme, dhe kjo është një prej arsyeve përse janë të vështira të arrijnë një marrëveshje të gjerë politike. Shumë grupe, sidomos ato më të moderuar, janë pro zhvillimit të një sistemi politik demokratik, bazuar në zgjedhje të lira dhe të drejta. Ata kërkojnë një kalim drejt paqes dhe stabilitetit, ku qytetarët sirianë do të kenë mundësinë të vendosin për të ardhmen e vendit.

Megjithatë, zhvillimet demokratike në Siri janë një mision i mundshëm, por shumë i vështirë, për disa arsye:

Së pari, sepse grupet janë shumë të fragmentuara në interesa dhe ideologji. Disa grupe kanë interesa dhe ideologji shumë të ndryshme, dhe kjo ka bërë të vështirë krijimin e një fronti të bashkuar.

Së dyti, është prania e grupeve Radikale si HTS dhe ato të tjera që lidhin luftën me ideologjitë islamike radikale, të cilat mund të pengojnë një kalim në një sistem demokratik, pasi ata kanë qëndrime të kundërta ndaj vlerave demokratike, si liria e besimit dhe pluralizmi politik.

Së treti, është mungesa e një mbështetjeje ndërkombëtare të qëndrueshme. Pavarësisht mbështetjes që disa grupe të moderuara kanë marrë nga perëndimi dhe shtetet e tjera të botës arabe, mungon një mbështetje e qëndrueshme dhe një plan i qartë për rindërtimin e një shteti demokratik në Siri. Kush do të bëhet organizatë apo vend ndërmjetës për të marrë përsipër ngritjen e shtetit të ri Sirian?

Së katërti, është bashkëpunimi i mëtejshëm me Assadin dhe me Rusinë, ku disa grupe janë akoma të gatshme të negociojnë me të, çka e bën zhvillimin e një shoqërie demokratike më të vështirë. Grupet që kanë mbështetur deri tani regjimin janë ato që kërkojnë kontroll mbi Sirinë, si Alavitët, grupe të tjera fetare dhe ata që e shohin Assadin dhe Rusinë si një garant të interesave të tyre në rajon.

Konkluzion. Pyetja që bëjnë pothuaj të gjithë agjencitë e mëdha të lajmeve është “What is next?”.

Sipas mediave Ruse, Assadi, ka marrë strehim politik në Kremlin. Gjithsesi, rrëzimi i këtij regjimi konfirmon jo vetëm lidhjet e ngushta mes diktatorëve dhe autokratëve, por edhe një shuplake e rëndë për të gjitha tiranitë, përfshi Rusinë – Putiniste, Kim-Jong-ët, Shtetet dhe organizatat terroriste.

Ndërsa SHBA-ja ka mbajtur një qëndrim asnjanes të konfliktit të brendshëm në Siri, duke u shprehur se “Grupet që rrëzuan regjimin në Siri kanë një histori të dyshimtë. Ata duhet të vlerësohen jo më nga fjalët, por nga veprat e tyre. SHBA-të do të bashkëpunojë me një qeveri demokratike, dalë nga zgjedhjet e lira, dhe që kërkon dialog dhe mirëkuptim”. Ndërsa Presidenti i zgjedhur Trump në një postim të fundit ka shprehur qëndrimin e tij të fortë: “Kjo nuk është lufta jonë. Tani për tani, ne do të presim si do të sillen!”.

Gjithsesi, grupi opozitar islamik sirian (HTS) dhe zyrtarë nga qeveria e përmbysur Assad-iste caktuan udhëheqësin politik të xhihadistëve, inxhinierin Mohammed al-Bashir, i cili gjithashtu ka luajtur një rol kyç në administratën e mbikëqyrur nga grupi islamik Hayat Tahrir al-Sham (HTS), për të formuar një qeveri kalimtare.

Nga ana tjetër, konflikti është shumë i ndërlikuar dhe me impakte të mëdha për sigurinë dhe politikën ndërkombëtare, për një të ardhme më të sigurt dhe më demokratike për Sirinë dhe rajonin.

17 dhjetori i 1912-s dhe fati i Shqipërisë

Më 17 dhjetor 1912, në orën katër e gjysmë të pasdites, në Zyrën e ministrit të Jashtëm anglez, Eduard Grey, u mbledhën ambasadorët e Fuqive të Mëdha evropiane, të cilët ishin të akredituar në oborrin anglez. Ky ishte një hap i rëndësishëm për ruajtjen e paqes evropiane. Gjatë çajit të përbashkët, të gjashtë ambasadorët diskutuan për të ardhmen e Ballkanit, përkatësisht të Shqipërisë. Konferenca e Londrës vulosi lindjen e Shqipërisë si një principatë autonome, sovrane dhe trashëgimtare nën garancinë e fuqive të mëdha, edhe pse gjysma e territoreve të saj mbetën nën pushtimin serb deri me shpërbërjen e Jugosllavisë në vitet e nëntëdhjeta.

Konferenca e Londrës e 1912-1913, e njohur edhe si Konferenca e Paqes në Londër ose Konferenca e Ambasadorëve, ishte një samit ndërkombëtar i gjashtë Fuqive të Mëdha të asaj kohe (Austro-Hungaria, Franca, Britania e Madhe, Gjermania, Italia dhe Rusia) që u mbledh në dhjetor të vitit 1912, për shkak të sukseseve të ushtrive të Lidhjes Ballkanike kundër Perandorisë Osmane në Luftën e Parë Ballkanike. Konferenca në veçanti synonte të arbitronte midis fuqive ndërluftuese për ndarjen e territoreve të pushtuara, si dhe të përcaktonte të ardhmen e Shqipërisë, e cila sapo kishte shpallur pavarësinë. Konferenca e Ambasadorëve e njohu Shqipërinë si një principatë autonome, sovrane dhe trashëgimtare nën garancinë e fuqive të mëdha.

Konstatimi i profesorit të historisë në Universitetin e Potsdamit, Gjermani, Manfred Gortemaker se “pa njohuri themelore të ngjarjeve të rëndësishme të shekullit XIX, nuk mund të arrihet një kuptim i thellë i botës sonë bashkëkohore”, vlen gjithashtu për rëndësinë e Konferencës së Ambasadorëve në Londër 1912/13. Edhe sot, kur politikë kombëtare, si dhe ato evropiane dhe ndërkombëtare përballen me sfida të mëdha në Evropën Juglindore, Konferenca e Ambasadorëve në Londër nuk ka humbur asgjë nga rëndësia e saj historike, veçanërisht për rajonin e Ballkanit. Disa nga problemet e sotme në këtë rajon të Evropës kanë lidhje të drejtpërdrejta me Konferencën e Londrës, megjithëse ngjarja daton 111 vjet më parë.

Përveç kësaj, Konferenca e Ambasadorëve në Londër është njëra nga ngjarjet e pakta në fillim shekullin XX, në të cilin një fuqi e madhe e Evropës – Austro-Hungaria, e mbështetur vazhdimisht nga Gjermania – kishte arritur të realizonte idenë e krijimit të një shteti shqiptar në kohën kur shtetet ballkanike të mbështetura nga Rusia kishin shënuar një fitore të madhe kundër një fuqie tjetër të madhe – kundër Perandorisë Osmane në fund të vitit 1912.

Ambasadorët e Konferencës në Londër

Më 2 dhjetor 1912, u nënshkrua një armëpushim midis Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi me Perandorinë Osmane. Në ndërkohë, Fuqitë e Mëdha u pajtuan që Londra të ishte një vend negociues për bisedimet e paqes. Në atë kohë Greqia nuk donte të bashkohej me një ndërprerje të armiqësive dhe vazhdoi të bënte luftë kundër Kostandinopojës.

Nisma gjermane për një konferencë paqësore

Paralelisht me negociatat e paqes midis Perandorisë Osmane dhe shteteve të Ballkanit, me sugjerimin e sekretarit gjerman të Shtetit, Kiderlen-Wächter, i cili në këtë mënyrë pengonte ambiciet luftarake austro-hungareze në nëntor 1912, lindi nisma për një konferencë ambasadore të fuqive të mëdha evropiane. Në gjysmën e dytë të nëntorit 1912, u dëgjuan për herë të parë ata oficerë dhe këshilltarë ushtarakë që bënë thirrje për veprim ushtarak të Austro-Hungarisë kundër Serbisë. Disa vendimmarrës në Monarkinë e Danubit tani filluan ndërhyrjen ushtarakë seriozisht. Veçanërisht në këtë kontekst bie në sy kthimi i trashëgimtarit të fronit Franz Ferdinand, i cili deri atëherë kishte përfaqësuar një qëndrim paqësor. Ai tani madje u përpoq të fitonte mbështetjen e aleatit të tij gjerman për veprime ushtarakë, edhe nëse kjo do të kishte shkaktuar një luftë kundër Rusisë dhe fuqive të tjera të mëdha evropiane. Në këtë situatë, udhëtimi i trashëgimtarit austro-hungarez në fron në Berlin, më 22 nëntor 1912, mori një rëndësi edhe më të madhe. Të nesërmen “Reichspost” publikoi një raport mbi rezultatet e vizitës marrë “nga një burim i veçantë”. Autori raportoi se ishte siguruar nga një prej “njerëzve kryesorë” se Rajhu Gjerman donte të ruante paqen (“Erzherzog Franz Ferdinand in Berlin”, “Reichspost” 19/546 (24 nëntor 1912) f. 1). Në fakt, në këtë bisedë, perandori gjerman fillimisht kishte deklaruar besnikërinë e tij ndaj Austro-Hungarisë në rast se “nderi” i Monarkisë së Danubit vihej në rrezik, edhe nëse kjo do të nënkuptonte luftë me Rusinë. Pas këtij qëndrimi



gjerman, perandori austro-hungarez, Franz Ferdinand, u çimentua në pozicionin e tij të miratuar tani që favorizonte një zgjidhje ushtarakë. Më 23 nëntor 1912, gazeta “Reichspost” në një editorial shkruante se mobilizimi rus mund t’i drejtohej vetëm “Austriisë dhe aleatit të saj gjerman” (“Rußland mobilisiert“, “Reichspost” 19/544 ,23 nëntor 1912, f. 1-2). Një ngjarje tjetër që mund të çonte në luftë midis Austro-Hungarisë dhe Serbisë ishte rasti i sulmit serb mbi konsullin austro-hungarez në Kosovë, Oscar Prochaska, e cila ndezi edhe më shumë rivalitetin ndërmjet Vjenës dhe Beogradit.

Siç raportonte anëtar i “Reichsrat-it” dhe profesori i drejtësisë, Joseph Redlich, i cili konsiderohej ekspert i rajonit, në atë kohë ka pasur edhe thashetheme se edhe Rajhu gjerman i rekomandoi Austro-Hungarisë “përdorimin më të madh të çështjes Prochaska

kundër Serbisë”. (Tagebucheintrag Redlichs vom 29 November 1912 in: Fritz Fellner (HG), Doris A. Corradini (HG): Schicksalsjahre Österreichs. f. 515-516). Mbi të gjitha, konfuzioni rreth sigurimit të aleancës gjermane, u vu në pikëpyetje në një artikull nga Sekretari Gjerman i Shtetit, Kiderlen-Wächter

Megjithatë, Perandoria gjermane nuk shihej të ishte tërësisht pas Austro-Hungarisë. Tani kishte raporte për përpjekjen e Gjermanisë për të ndërmjetësuar midis Austro-Hungarisë dhe Rusisë. Do të kishte një propozim kompromisi për këtë çështje, porti serb në bregdetin shqiptar të Adriatikut. Në Gjermani, qëndrimi i Austro-Hungarisë shihet si një pengesë për një zgjidhje paqësore. Për më tepër, Austro-Hungaria kishte një qëndrim negativ ndaj idesë për një konferencë paqësore.



Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha Evropiane në Londër

Nisma gjermane u mirëprit nga ministri i Jashtëm anglez, Eduard Grey, i cili u propozoi Fuqive të Mëdha një konferencë ambasadorësh nëpërmjet së cilës fuqitë e Koncertit Evropian nuk dëshironin që, për shkak të Ballkanit, të fillonte një luftë me përmasa evropiane ose botërore, çka do të rrezikonte edhe interesat e Aleancës Trepalëshe, por edhe të shteteve të Antantës. Kështu më 16 dhjetor 1912, ambasadorët e atyre vendeve që kishin nënshkruar Traktatin e Berlinit të vitit 1878, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia, u takuan për një konferencë në Londër.

Më 17 dhjetor 1912, në orën katër e gjysmë të pasdites, në Zyrën e ministrit të Jashtëm anglez, Grey, u mblodhën ambasadorët e Fuqive të Mëdha evropiane, të cilët ishin të akredituar në oborrin anglez. Ky ishte një hap i rëndësishëm për ruajtjen e paqes evropiane.

Gjatë çajit të përbashkët, të gjashtë ambasadorët diskutuan për të ardhmen e Ballkanit, përkatësisht të Shqipërisë. Veç kësaj, diskutimet kishin edhe një karakter thuajse familjar, meqenëse ambasadorët e Austro-Hungarisë, Rusisë dhe të Gjermanisë, Alberti, konti fon Mendorf, Aleksandri, konti fon Bekendorff (me prejardhje gjermane) dhe Maks princ Lihnovski, ishin të afërm. Krahas këtyre morën pjesë në mbledhje edhe Marchese Guglielmo Imperiali për Italinë dhe Jules Cambon për Francën. Ministri i Jashtëm anglez e drejtoi kryesinë e Konferencës së Ambasadorëve.

Për pavarësinë e Shqipërinë dhe një lidhje të Serbisë me Adriatikut

Më 21 nëntor 1912, ministri anglez e pranoi propozimin gjerman. Ai propozoi një program me tri pika për këshillime midis Fuqive të Mëdha.

Sipas kësaj, Fuqitë duhej të diskutonin për: pavarësinë e Shqipërisë; për një lidhje të Serbisë me Adriatikut; për të ardhmen e ishujve grekë të Egjeut.

Ekzistonte konsensusi midis vendeve pjesëmarrëse për të mos lejuar që konflikti në Ballkan të përshkallëzohej në një luftë serioze që do të përfshinte edhe fuqitë e mëdha evropiane. Gjatë bisedimeve pati edhe tensione serioze diplomatike midis fuqive të mëdha evropiane. Ndërkohë, Austro-Hungaria përfaqësoi pozicionet e saj të njohura për Ballkanin, ku në qendër të vëmendjes vazhdonte të ishte kërkesa përprjekja e saj për një Shqipëri të pavarur dhe skicimi i kufijve sipas parimit etnografik. Një çështje tjetër në fillim të vitit 1913 ishte çështja e rrethimit, përkatësisht e pushtimit të Shkodrës nga Mali i Zi, për çka Austro-Hungaria madje mori masa për të ndërmarrë mobilizim ushtarak kundër Cetinës. Një luftë eventuale ndërmjet Austro-Hungarisë dhe shteteve ballkanike, pa dyshim do të përfshinte edhe Gjermaninë, për çka diplomati i saj në Londër kishte paralajmëruar me kohë se do ta rreshtonte Anglinë në pozicion armiqësor ndaj Berlinit.

Për rëndësinë që kishte Konferenca e Ambasadorëve në Londër, tregon fakti se shteti gjerman riktheu nga pensioni një nga ambasadorët e saj më të mirë, Princin Karl Max Lichnowsky. Perandori Wilhelm II, me gjithë rezistencën e kancelarit të Rajhut dhe Ministrisë së Jashtme, e kishte emëruar Lichnowskyn ambasador në Londër dhe ia besoi detyrën për të “siguruar neutralitetin e Anglisë”. Megjithatë, vetëm dy javë pas mbërritjes së tij në Londër, Lichnowsky raportoi shumë qartë në Berlin mbi parimin bazë të politikës së jashtme britanike: Anglisë do t’i duhet gjithmonë të përpiqet të ruajë ekuilibrin e fuqive në kontinent. Në një luftë midis Gjermanisë dhe Francës e Rusisë, Anglia do të ishte në anën e armikut.

Vlen të shënohet se Lichnowsky gëzonte respekt dhe besim të madh te autoritetet angleze dhe te vetë ministri i Jashtëm anglez, Grey. Po ashtu, edhe gruaja e tij, shkrimtarja Princesha Mechthilde Lichnowsky, duke qenë një grua e zgjuar dhe intelektuale, kontribuoi në faktin që ambasada gjermane në Londër avancoi në një pikëtakimi për mbretërinë britanike.

Në këtë periudhë, Gjermania kishte në detyrë korpusin e diplomatëve më profesionistë, shumica syresh vinin nga radhët e fisnikërisë gjermane dhe mbanin postet më të rëndësishme diplomatike në Evropë: Në Francë ishte Baroni von Schoen, ish-Sekretar Shtetëror i Ministrisë së Jashtme); Heinrich von Tschirschky dhe Bogendorff në Austro-Hungari; në Rusi, Konti Pourtalès; në Itali Gottlieb von Jagow (më vonë Sekretar Shteti në Ministrinë e Jashtme).

Ambasadori gjerman në Britaninë e Madhe, Princi Lichnowsky, duke poseduar një eksperiencë të gjatë profesionale dhe zotësi intelektuale luajti një rol të rëndësishëm në këtë konferencë ndërkombëtare të paqes, madje shpeshherë ai veproi përtej instruksioneve të Berlinit.

“Menjëherë pas mbërritjes sime në Londër, në fund të vitit 1912, Sir E. Grey propozoi një bisedë jozyrtare për të parandaluar që Lufta Ballkanike të mos shndërrohej në një luftë evropiane... Burrështetasi britanik që në fillim mbajti qëndrimin se Anglia nuk kishte asnjë interes për Shqipërinë dhe nuk kishte ndërmend të hynte në luftë për këtë çështje”, shkruante në memoaret e tij.

Lufta e Parë Ballkanike, e cila rezultoi me kolapsin e Perandorisë Osmane, rrjedhimisht ishte një disfatë për politikën e jashtme gjermane, pasi qe identifikuar për një kohë të gjatë për raportet e ngushta ekonomike dhe ushtarake me Portën e Lartë. Pasi që shteti osman në Evropë nuk mund të ruhej më, kishte dy opsione drejt zgjidhjes së trashëgimisë së tij: ose shteti gjerman të deklaronte mosinteresimin e tij të plotë në skicimin e kufijve në Ballkan dhe popujve ballkanikë t’u lihej rregullimi i tyre, ose ndryshe Berlini të mbështeste “aleatin” e vet Austro-Hungarinë dhe këtë mënyrë të hiqte dorë nga roli ndërmjetësues.

Edhe pse ambasadori Lichnowsky që në fillim kishte mbështetur zgjidhjen e parë, domethënë përfshirjen gjermane në rregullimin e problemeve ballkanike, megjithatë, siç thotë ai, Ministria e Jashtme në Berlin mbajti një qëndrim më të vendosur te pozicioni i fundit, duke shtuar se thelbi i çështjes në Konferencën e Ambasadorëve ishte çështja shqiptare. “Aleatët tanë dëshironin krijimin e një shteti të pavarur shqiptar, pasi austriakët nuk donin që serbët të merrnin hyrjen në Adriatik, dhe italianët nuk donin që grekët të arrinin në Valona apo edhe në veri të Korfuzit. Në kundërshtim me këtë, Rusia, siç dihet, po mbështet dëshirat e Serbisë dhe Franca ato të Greqisë”, nënvizonte Lichnowsky.

Lufta e Dytë Ballkanike dhe kufijtë e cunguar të shtetit shqiptar Vetëm pak javë pas marrëveshjes së paqes në Londër, në qershor 1913 shpërtheu Lufta e Dytë Ballkanike. Kjo luftë rezultoi në konflikte të armatosura midis anëtarëve të Lidhjes Ballkanike. Përfundimisht, konflikti rezultoi për çështjet e hapura, përkatësisht lidhur me atë se si duhej të ndaheshin mes shteteve ballkanike territoret e pushtuara të Perandorisë Osmane. Pavarësisht Traktatit të Paqes të Londrës, ndarja territoriale e Maqedonisë në veçanti çoi në konflikt. Serbisë iu dha si kompensim një pjesë e konsiderueshme e Maqedonisë për shtetin e ri shqiptar, por që në të njëjtën kohë pretendoheshin nga Bullgaria. Mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidheshin përfundimisht në Londër.

Por, pavarësisht pritjeve të mëdha, Konferenca e Ambasadorëve në Londër nuk arriti të bënte një hap të duhur për vendosjen e paqes së qëndrueshme në Ballkan, ashtu siç ia kishte dalë Kongresi i Vjenës, ajo dha vetëm pak kohë, por nuk arrinte ta mënjanonte Koncertin Evropian nga rruga e rrezikshme, e cila e çoi kontinentin në një greminë me pasoja të mëdha, në Luftën e Parë Botërore, e cila konsiderohet në fakt si vazhdim i luftërave ballkanike.

Sidoqoftë, ajo që mbetet e rëndësishme është se kjo konferencë evropiane vulosi lindjen e Shqipërisë si një principatë autonome, sovrane dhe trashëgimtare nën garancinë e fuqive të mëdha, edhe pse gjysma e territoreve të saj mbetën nën pushtimin serb deri me shpërbërjen e Jugosllavisë në vitet nëntëdhjeta. Ishte momenti historik kur Shqipëria do t’i bashkohej ansambllit të shteteve evropiane përmes një princi gjerman, Wilhel von Wied.

Po kështu, me këta kufij të cunguar të shtetit shqiptar, të vendosur me insistimin këmbëngulës të Rusisë dhe mbështetjen e Francës, lindi çështja e Kosovës, e cila pas një shekulli arriti të depërtonte në agjendën e kancelarive evropiane, të gjashtë shteteve anëtare të Grupit të Kontaktit, ku me përkrahjen e Francës dhe të vendeve të tjera anëtare u bë e mundur të izolohej Rusia, e cila si një shekull më parë po ndiqte me këmbëngulje agjendën serbomadhe.



(Fotografia: Reuters/Maja Smiejkowska)

Aleatët e NATO-s festojnë 75-vjetorin e Aleancës

Traktati i Atlantikut të Veriut u nënshkrua më 4 prill 1949 nga 12 anëtarët themelues të NATO-s. Në 75 vjet që nga ajo kohë, Aleanca është rritur duke përfshirë 32 aleatë nga Evropa dhe Amerika e Veriut. Gjatë gjithë vitit 2024, aleatët e NATO-s festuan 75-vjetorin e Aleancës dhe përvjetorët e anëtarësimit të tyre në NATO, duke pikturuar murale, duke luajtur muzikë, duke ndarë tortën e ditëlindjes dhe duke sjellë blunë e NATO-s në çdo cep të Aleancës.

Duke valëvitur flamurin

Mbretëria e Bashkuar festoi 75-vjetorin e Aleancës duke valëvitur flamurin e NATO-s - dhe flamujt kombëtarë të të 32 aleatëve të NATO-s - përgjatë "The Mall" që çon në Pallatin Buckingham në Londër. Kryeqyteti i Mbretërisë së Bashkuar është veçanërisht i rëndësishëm në historinë e NATO-s, pasi shërbeu si shtëpia e selisë së NATO-s për tre vitet e para të Aleancës.



Anëtarë më i ri i NATO-s, Suedia, u bashkua me Aleancën më 7 mars 2024. Për të shënuar këtë moment historik, Suedia ngriti flamurin e NATO-s së bashku me ngjyrat e veta kombëtare në të gjithë vendin - duke përfshirë përpara pallatit Arvfurstens, selinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme suedeze në Stokholm. Në prag të pranimit të Suedisë në NATO, prodhuesit suedezë të flamujve ishin të zënë me prodhimin e qindra flamujve të NATO-s për t'i ngritur zyrat qeveritare, bizneset dhe qytetarët privatë.



Më 4 prill 2024, Finlanda festoi jo vetëm 75-vjetorin e Aleancës, por edhe një vjetorin e anëtarësimit në NATO. Ashtu si aleati i saj nordik Suedia, Finlanda ngriti flamujt e NATO-s së bashku me flamujt e saj kombëtarë përpara Pallatit Presidential në Helsinki në Ditën e NATO-s.



(Fotografia: NATO)

Si shtëpia e selisë së NATO-s, Belgjika priti një ceremoni zyrtare në ditën e vetë 75-vjetorit të NATO-s, 4 prill 2024. Jashtë selisë së NATO-s, monumentet në të gjithë Brukselin u dekoruan për të shënuar përvjetorin e NATO-s. Statuja ikonë "Manneken Pis", një nga simbolet më të njohura të Brukselit, veshi një kostum të veçantë të Ditës së NATO-s për t'iu bashkuar festimeve.



Gjatë gjithë vitit të 75-vjetorit, Asociacioni i NATO-s i Kanadasë u kërkoi njerëzve të dërgonin foto të flamurit blu të firmës së Aleancës që fluturonte në vende krijuese dhe domethënëse në të gjithë vendin. Një dorëzim tregoi flamurin e NATO-s në "Seacow Head Lighthouse" në ishullin Prince Eduard, një pikë referimi lokale e bërë e famshme nga seria televizive Road to Avonlea, bazuar në tregimet e Anne of Green Gables të autores kanadeze Lucy Maud Montgomery. Vende të tjera përfshijnë degët e Legjionit Mbretëror Kanadez, varrezat ushtarake dhe shtëpitë e njerëzve.



Gjermania festoi 75-vjetorin e Aleancës duke valëvitur flamurin e NATO-s së bashku me flamurin gjerman dhe atë të Bashkimit Evropian në zyrat qeveritare në të gjithë Berlinin, duke përfshirë edhe para ndërtesës ikonë të Bundestagut.



Letonia shënoi 20 vjetorin e saj në NATO me disa festime, duke përfshirë me ushtarë dhe civilë që shpalosën flamurin e 20-vjetorit të Letonisë përpara Monumentit të Lirisë në Riga gjatë një vizite të Kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s më 28 mars 2024.



Lituania festoi 20-vjetorin e anëtarësimit në NATO duke valëvitur një flamur gjigant prej 540 metrash katrorë të NATO-s nga Kulla e TV Vilnius - ndërtesa më e lartë në Lituani - gjatë ditës dhe duke ndezur pikën referuese në blu të NATO-s gjatë natës.

Duke u nisur drejt qiellit



Kroacia festoi 15 vjetorin e anëtarësimit në NATO më 1 prill 2024. Për të shënuar këtë moment historik, më 25 prill 2024, Shigjetat e Kuqe të Forcave Ajrore Mbretërore të Mbretërisë së Bashkuar kryen një shfaqje ajrore në bazën ajrore Zemunik në Kroaci, duke shfaqur ngjyrat kombëtare kroate për nder të aleatin e tyre të NATO-s.



Normalisht, simboli i vetëm në avionët luftarakë të Danimarkës është flamuri kombëtar danez. Por për 75-vjetorin e NATO-s, Forcat Ajrore Mbretërore Daneze pikturuan stemën e NATO-s në bishtin e një F-16 “Fighting Falcon”, duke e çuar në qiell këtë simbol të unitetit aleat.



Më 21 gusht 2024, avionët italianë dhe amerikanë performuan në një shfaqje ajrore të 75-vjetorit të NATO-s në Hampton Roads pranë Virginia Beach në Shtetet e Bashkuara. Forca ajrore italiane Frece Tricolori kryesoi demonstratën me tymin e tyre jeshil, të bardhë dhe të kuq që zvarritet nëpër qiell. Të njohur si “Shigjetat Trengjyreshë”, ekipi vizitoi Amerikën e Veriut për herë të parë në më shumë se 30 vjet.



Rumania priti gjithashtu një shfaqje ajrore duke festuar 75 vjetorin e NATO-s dhe 20 vjetorin e anëtarësimit të vendit në NATO. Më 3 gusht 2024, ekuipazhet ajrore rumune dhe amerikane performuan për publikun në bazën ajrore Mihail Kogălniceanu pranë Detit të Zi. Si pjesë e shfaqjes, një parashutist me një parashutë flamuri rumun mbante flamurin e NATO-s ndërsa zbriste.



Për të festuar 25 vjetorin e anëtarësimit në NATO, Polonia organizoi avionë luftarakë F-16 dhe trupa polake në një formacion busull të NATO-s.

Duke qëndruar me trupat



Përpara 15 vjetorit të anëtarësimit në NATO, Shqipëria rihapi zyrtarisht bazën ajrore të Kuçovës më 4 mars 2024, pasi e transformoi bazën ajrore të epokës sovjetike me dekada në një qendër moderne për operacionet e ardhshme ajrore të NATO-s. E vendosur rreth 80 kilometra në jug të Tiranës, Baza Taktike Ajrore e NATO-s në Kuçovë do t'i shërbejë Shqipërisë dhe do të mbështesë logjistikën, operacionet ajrore, stërvitjen dhe stërvitjet e Aleancës.



Trupat në Brigadën Shumëkombëshe të NATO-s në Letoni festuan 75-vjetorin e Aleancës më 4 prill 2024 me një tortë të madhe ditëlindjeje të NATO-s, të mbuluar me manaferra të freskëta dhe krem blu të NATO-s.

Stafi civil dhe ushtarak që punon në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) në Mons, Belgjikë festoi përvjetorin e NATO-s më 4 prill 2024 duke formuar numrin 75 dhe duke mbajtur lart flamurin e NATO-s. (Fotografia: SHAPE/SFC Dennis Sattler)

Duke bërë art publik

Si pjesë e festimeve të Bullgarisë për 20-vjetorin e anëtarësimit në NATO, Ministria e Punëve të Jashtme organizoi një konkurs të artit në rrugë të quajtur “Bullgaria - më e bukur në NATO”. Më 7 nëntor 2024, e para nga pesë muralet e artit të grafitit u zbulua në Blagoevgrad. Krijuar nga studioja e grafitëve “The Graffs”, murali përshkruan një ushtarë të re me një distinktiv të NATO-s në supe. Ushtari mban një bimë që mbin dhe është i rrethuar nga male të qeta dhe një peizazh shumëngjyrësh.



Estonia shënoi 20-vjetorin e anëtarësimit në NATO me aktivitete të shtrirjes publike në të gjithë vendin, duke përfshirë demonstrime të pajisjeve ushtarake nga trupat e grupit të betejës shumëkombëshe të NATO-s në Estoni. Kjo përfshinte forcat estoneze, franceze dhe të Mbretërisë së Bashkuar - dhe orkestrën “Pipes and Drums” të Ushtrisë Britanike që performonte valle tradicionale për publikun në sheshet e qytetit.



Festivali i NATO-s në Norfolk festoi 71-vjetorin e tij në 2024, duke bashkuar aleatët nga e gjithë Evropa dhe Amerika e Veriut në Norfolk, Virxhinia - shtëpia e Komandës Aleate të NATO-s për Transformimin (ACT). Gjatë paradës kryesore të festivalit, ushtarët francezë nga skuadra ushtarake e regbit XV du Pacifique, e cila përbëhet nga trupa nga territoret franceze të Paqësorit, Polinezia, Kaledonia e Re dhe Wallis dhe Futana, performuan një valle tradicionale haka për publikun.



Më 8 prill 2024, Komanda e Forcave të Përbashkëta të NATO-s në Napoli organizoi një koncert të 75-vjetorit në “Teatro di San Carlo”, teatrin historik të qytetit - shtëpia më e vjetër e operës në botë, e cila daton në vitin 1737. Koncerti shfaqti muzikë nga grupi i Forcave Detare të SHBA-së në Evropë dhe 11 muzikantë nga aleatët e tjerë, duke përfshirë një kor shfaqjeje të veshur me blunë e NATO-s. Ajo pa gjithashtu debutimin e një kompozimi të ri muzikor, “Defend Every Inch; #WEARENATO” i kompozuar nga Dr. dhe Kryemuzikant Christopher Buchanan.



Në prag të 20 vjetorit të anëtarësimit të saj në NATO, Sllovenia priti një festë kombëtare në Brdo pri Kranju (Kështjella e Brdo), e cila shfaqti gjithashtu shfaqje muzikore për të festuar NATO-n.

Më 10 korrik 2024, gjatë Samitit të NATO-s 2024 në Uashington D.C., udhëheqësit e të 32 Aleatëve të NATO-s morën pjesë në një darkë shtetërore në Shtëpinë e Bardhë. Veprimtaria përfshinte një performancë marshimi bande nëpër lëndinën e Shtëpisë së Bardhë.



Dollia, kumt i trashëgimisë kulturore

Erritur në tryeza familjare, ku gëzimet mblidhnin bashkë pjesëtarët e familjes së madhe, ajo që më binte në sy ishte ngritja e gotave të rakisë, e cila shoqërohej me shprehjen “këtë dolli e ngre për shëndetin tënd” dhe kështu mesnata të gjente me këtë rit për shëndetin dhe mirësinë e gjithë të pranishmëve.

Dolli që nga fëmijëria

Dollia si ‘institucion’, roli i mikut, impenjimet në ceremonial të palës pritëse dhe përjetimi emocional i veçantë i dollisë, të cilat të rrëqethin, të bëjnë të ndihesh krenar për këtë rit të bukur.

“Dollia e ngre mikun në pedestal”

Dollia është një skenë ku promovohen arritjet dhe vlerat njerëzore. Është një lloj i veçantë ligjërimi. “Dollibashi është lideri që dirigjon, drejton sofrën, tryezën, odën dhe ka një qëllim: t’i bëjë të lumtur pjesëmarrësit, t’i bëjë ata sa më të kënaqur”.

“Aty e ka pushtetin dhe magjinë fjala, e jo sasia e alkoolit që konsumohet”, dollitë vijnë nga lashtësia, në dasma, fejesa, pritje, përcjellje e gosti.

Nuk është e thjeshtë të ngresh dolli. Duhet ta njohësh mirë mikun, t’ia dish vlerat dhe t’u përmbahesh disa rregullave, disa herë edhe të ashpra.

Dollia haset edhe në veri, edhe në jug, por si kod shpirtëror, me rregulla shpesh të ashpra gjendet në jug, veçanërisht në zonat: Skrapar, Përmet, Dangëlli, Frashër, Dëshnicë, Kolonjë, Gramsh, Mokër, Mallakastër, Lunxhëri, Berat, Himarë etj.

Është një rit me kode, siç janë ligjet me nene. “Që të kompozohet një dolli, duhet të futen në rol disa persona, mbi të gjithë një person që është ‘dollibashi’, ai që ngre disa shëndete me gotën me raki, që rendit vlerat e atyre njerëzve që ai u çon shëndet dhe e meritojnë të veçohen.

Nga dollibashi ai gjen apo kërkon një partner, që quhet pritësi i dollisë. Ata dialogojnë bashkë. Dollibashi ia shpjegon pritësit cilësitë e virtytet e atij për të cilin ngrihet dollia. Më pas, të gjithë pjesëmarrësit ftohen nga pritësi ta ngrenë shëndetin për atë për të cilin u thanë fjalët e mira”, dollia ka edhe aktorë të tjerë si pritësin e dollisë, i cili në disa zona apo krahina quhet edhe sekretar i dollisë dhe po kështu edhe “saku”, personi që është i ngarkuar për të mbajtur drejtësi në tryezë a sofër, i cili mbush gotat e rakisë e që kujdeset që të gjithë të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Saku, është syri i kujdesshëm i sofrës, që përfaqëson atë që është mikpritësi. Siç ka rregulla, dollia ka edhe detyrime.

“Ka rregulla se kush bëhet dollibash, si zgjidhet, apo si e fiton këtë protagonizëm. Kur i sheh kështu veçmas, të duken të ashpra, por kur e kupton se këto rregulla janë bërë që të ruhet harmonia në tryezë, e kupton se dollia është margaritar”.

“Kur dollibashi ngre një shëndet, bën komente për atë për të cilin e ngre shëndetin, por janë komente që të rrëqethin, të bëjnë me krahë, të bëjnë të thuash me vete se sa bukur i tha ato fjalë. Kjo e bën dollinë të veçantë”.

Dollia, “autoktone shqiptare”

Rakia, vera, mikpritja nuk janë vetëm shqiptare, ndërsa dollia po. Ka autenticitet të plotë shqiptar. Nuk ka dolli as në vende të tjera të rajonit, as të Mesdheut. Ajo ka evoluar nga monolog që ngjason me rapsoditë, në dolli që ngrihen mes dy personave dhe të tjerët heshtin... Ka evoluar përgjatë shekujve, por është autentike dhe ka disa diferenca të vogla sipas zonave.

Profesori i Financave në Shqipëri dhe në Francë, Sherif Bundo, është ndër nismëtarët e një grupi të madh intelektualësh, personalitetesh të njohura, por edhe bashkive dhe shoqatave që kërkojnë që dollia të shpallet pasuri kombëtare e trashëgimisë kulturore shpirtërore. Njëlloj si polifonia. Dosja është dorëzuar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Vendimi nuk është marrë ende, por është në rrugë procedurale. Më pas i takon Ministrisë ta dërgojë dosjen në UNESCO, sepse i plotëson të gjitha kriteret. Kjo do të kërkojë kohë, por kam bindjen se edhe në UNESCO do të miratohet si pasuri botërore shpirtërore.

Profesor Bundo thotë se: “Në terren e vërej rrezikun që dollia të zhduket si vlerë shpirtërore, ndaj duhet mbrojtur sa më shpejt, të rinjtë janë të dhënë pas modernizmave. Pasuria kulturore është e rrezikuar nga globalizmi apo harresa. Kjo edhe ngase nuk ka ligje apo institucione që ta mbrojnë”, përfundon profesori.



RAKIA, VERA, MIKPRITJA NUK JANË VETËM SHQIPTARE, NDËRSA DOLLIA PO. KA AUTENTICITET TË PLOTË SHQIPTAR. NUK KA DOLLI AS NË VENDE TË TJERA TË RAJONIT, AS TË MESDHEUT. AJO KA EVOLUAR NGA MONOLOG QË NGJASON ME RAPSODITË, NË DOLLI QË NGRIHEN MES DY PERSONAVE DHE TË TJERËT HESHTIN... KA EVOLUAR PËRGJATË SHEKUJVE, POR ËSHTË AUTENTIKE DHE KA DISA DIFERENCA TË VOGLA SIPAS ZONAVE.

Shkencëtarët paralajmërojnë: 'Bakteret pasqyrë' mund të zhdukin njerëzimin

Shkencëtarët kanë lëshuar një paralajmërim urgjent mbi rrezikun e 'paprecedentë' të shkaktuar nga një jetë e krijuar në laborator, e cila mund të zhdukë njerëzimin.

E ashtuquajtura "jeta e pasqyrës" janë organizma sintetikë që janë ndërtuar nga versionet e pasqyruara të molekulave që gjenden në natyrë.

Ekspertët paralajmërojnë se këta organizma pasqyrë do të ishin "të padukshëm" për jetën në Tokë, duke i lejuar ata të kalojnë mbrojtjen imune të të gjithë organizmave të njohur.

Nëse bakteret pasqyrë do të iknin nga laborator, nuk do të kishte asgjë që t'i pengonte ata të vendoseshin në natyrë dhe të kërcënonin bimët, kafshët dhe njerëzit me infeksione vdekjeprurëse.

Krijimi i baktereve pasqyrë është të paktën një dekadë larg, por, në një përmbledhje teknike prej 300 faqesh të botuar në "Science", autorët vënë në dukje se tashmë po bëhet përparim i shpejtë.

Një grup prej 38 laureatësh Nobel dhe ekspertë të tjerë, duke përfshirë disa që më parë janë përpjekur të krijojnë jetë pasqyre, tani po bëjnë thirrje për një pauzë në të gjitha kërkimet e reja.

Dr. Vaughn Cooper, një mikrobiolog nga Universiteti i Pitsburgut dhe bashkautor i punimit, thotë: "Kjo formë e jetës nuk ka ekzistuar apo evoluar kurrë, për rrjedhojë, të gjitha ndërveprimet biologjike do të ishin të ndryshme ose ka të ngjarë të mos funksiononin.

"Ne nuk duam ta kufizojmë atë premtim të biologjisë sintetike, por ndërtimi i një bakteri pasqyrë nuk ia vlen të rrezikohet".

Ashtu si dora juaj e majtë është një imazh pasqyrë i së djathtës suaj, shumë molekula biologjike gjithashtu kanë një molekulë pasqyrë të majtë dhe të djathtë.

Ajo që e bën këtë veçori kaq të rëndësishme për biologjinë është se nuk ndryshon nga speciet në specie - molekulat që përbëjnë të gjithë jetën në Tokë kanë të njëjtën dorë.

Për shembull, spirale e dyfishtë spirale e ADN-së është e djathtë, ndërsa proteinat përbëhen nga aminoacide të dorës së majtë.

Megjithatë, për aq sa mund të thonë shkencëtarët, fakti që ADN-ja jonë është me dorën e djathtë është një rast evolucionar dhe nuk ka asnjë arsye që jeta të mos ketë evoluar nga komponentët e pasqyruar.

Pra, megjithëse jeta në pasqyrë nuk mund të evoluojë nga jeta siç e njohim ne, shkencëtarët besojnë se është e mundur të krijohej një organizëm në të cilin pasqyrohen të gjitha molekulat biologjike.

Ajo që do ta bënte këtë kaq të rrezikshme është se jeta në Tokë ka evoluar vetëm për t'u marrë me një formë molekule.

Bashk autori Profesor Gregory Winter, një biolog fitues i çmimit Nobel nga Universiteti i Kembrixhit, tha për MailOnline: "Rreziku i jetës në pasqyrë, në veçanti bakteret e pasqyrës, është se organizmat e gjallë nuk do t'i njohin homologët e tyre pasqyrë si 'të huaj' dhe nuk kanë mbrojtje natyrore për t'u mbrojtur nga sulmet e tyre.

Për shembull, njerëzit do të luftonin për të krijuar antitropa kundër baktereve të pasqyrës dhe nuk do të ishin në gjendje të kontrollonin një infeksion. Argumente të ngjashme vlejnë për të gjithë organizmat e tjerë të gjallë, duke përfshirë bimët e sulmuara nga bakteret pasqyrë".

Çfarë është jeta në pasqyrë?

Jeta në Tokë ka evoluar duke pasur ADN-në e djathtë dhe aminoacide të dorës së majtë. Shkencëtarët e quajnë këtë natyrshëm kiral.

Në jetën e pasqyrës, të gjitha këto molekula do të zëvendësoheshin nga alternativa e tyre e pasqyruar.

Një organizëm pasqyrë do të jetë në gjendje të funksionojë normalisht, përveç faktit që proceset kimike natyrale kirale nuk do të ndërveprojnë me të. Kjo do të thotë se një bakter pasqyrë ka të ngjarë të jetë i padukshëm ndaj përgjigjeve imune të çdo organizmi natyral kiral në Tokë.

Po kështu, grabitqarët natyrorë të baktereve gjithashtu mbështeten gjerësisht në aftësinë e molekulave të gjahut të tyre për të vrarë bakteret.

Kjo do të thotë se nuk ka asgjë për t'i ndaluar bakteret mashtruese të pasqyrës që të shpëtojnë në natyrë dhe të shumohen pa kontroll.

Autorët shkruajnë: "Ne nuk mund të përjashtojmë një skenar në

të cilin një bakter pasqyrë vepron si një specie pushtuese në shumë ekosisteme, duke shkaktuar infeksione vdekjeprurëse të përhapura në një pjesë të konsiderueshme të specieve bimore dhe shtazore, duke përfshirë njerëzit".

Edhe nëse njerëzit gjejnë një mënyrë për të mbrojtur veten nga ky kërcënim i ri, bakteret pasqyrë mund të destabilizojnë ende pjesë të mëdha të ekosistemit të botës.

Bashk autori Dr. Nicholas Talbot, një ekspert i sëmundjeve të bimëve dhe drejtor ekzekutiv i Laboratorit Sainsbury tha për MailOnline: "Duket shumë e mundshme që një bakter pasqyrë do të jetë në gjendje të infektojë disa bimë. "Nëse kulturat kryesore ushqimore do të ishin të ndjeshme, ndikimi do të ishte shkatërrues - krahas efekteve të tjera".

Lajmi i mirë është se teknologjia për të krijuar jetë pasqyre është ende larg. Në punimin e tyre, autorët vërejnë se ka pasur përparime të rëndësishme në krijimin e molekulave të pasqyrës dhe ndërtimin e qelizave artificiale.

Megjithatë, krijimi i molekulave sintetike është jashtëzakonisht i shtrenjtë dhe do të kërkonte përparime masive në fushën e kërkimit të qelizave sintetike.

Dr. Talbot thotë: "Pengesat teknike për të krijuar baktere pasqyre janë të rëndësishme, kështu që kjo është ndoshta të paktën një dekadë larg nga të qenit e mundur, por ne u ndjemë mjaftueshëm të shqetësuar për rrezikun që donim të krijojmë një diskutim publik për këtë shumë kohë përpara se të bëhej një realitet".

Studiuesit po bëjnë thirrje për një shqyrtim më të madh të hulumtimit të tyre dhe arrijnë në përfundimin se, nëse nuk dalin prova bindëse për të kundërtën, bakteret pasqyrë nuk duhet të krijohen.

Ndërsa ka disa përfitime të mundshme të baktereve të pasqyrës, të tilla si sinteza biologjike e barnave dhe aplikimet mjekësore, autorët argumentojnë se rreziqet nuk ia vlen.

Dr. Cooper përfundon: "Do të kërkonte përpjekje të mëdha për të ndërtuar një organizëm të tillë, por ne duhet ta ndalojmë atë

përparim dhe të kemi një dialog të organizuar, gjithëpërfshirës se si ta qeverisim këtë në mënyrë efektive".

Sa afër janë shkencëtarët me krijimin e jetës në pasqyrë?

Fakti që jeta në Tokë evoluoi për të pasur aftësinë biologjike që ka tani, besohet kryesisht të jetë një rast evolucionar.

Kjo do të thotë se nuk ka asnjë arsye që jeta në pasqyrë të mos jetë në gjendje të zhvillohet dhe të mbijetojë.

Meqenëse evolucion i lëviz nga ndryshimet në rritje, nuk ka asnjë mënyrë që jeta në pasqyrë të evoluojë nga gjendja aktuale e jetës në Tokë.

Mënyra e vetme për formimin e jetës në pasqyrë do të ishte që shkencëtarët të ndërtonin organizmin nga e para nga molekulat e pasqyrës të krijuara artificialisht.

Të bësh këtë, edhe për një organizëm të thjeshtë si një bakter, aktualisht është shumë përtej çdo gjëje që shkenca ka arritur ndonjëherë.

Megjithatë, shkencëtarët janë gjithnjë e më shumë në gjendje të krijojnë molekula komplekse të imazhit të pasqyrës nga blloqet bazë kimike të ndërtimit.

Kohët e fundit, studiuesit kanë qenë në gjendje të krijojnë proteina të mëdha funksionale të pasqyrës dhe madje edhe përbërës të ADN-së së pasqyrës.

Në të njëjtën kohë, shkencëtarët po bëjnë përparim të shpejtë në ndjekjen e ndërtimit të qelizave sintetike.

Sapo shkencëtarët janë në gjendje të ndërtojnë një qelizë nga pjesët jo të gjalla të dorës së natyrshme, nuk ka asgjë që i pengon ata të përdorin këtë teknikë në pjesët e pasqyruara.

Megjithatë, teknologjia e kërkuar për këtë nuk është vetëm përtej çdo gjëje të arritur ndonjëherë, por gjithashtu do të ishte tepër e shtrenjtë.

Aktualisht, studiuesit vlerësojnë se ka rreth një dekadë përpara se të jetë e mundur të krijohej organizmi i parë pasqyrë nëse nuk bëhet diçka për të ndaluar këtë kërkim.





NE JEMI NATO

